



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.SH.II.nr.947/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Ramush Bardiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit/propozuesit të masës së sigurimit TENZOR I.S.S.L.L.C. me seli në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson Valdrin Behrami avokat në Prishtinë, kundër të paditurit/kundërshtarit të sigurimit TENZOR KOSOVO shpk me seli në Prishtinë, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Atdhe Dika avokat në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditurit/kundërshtarit të sigurimit, të paraqitur kundër aktvendimit KE.nr.2808/22 datës 26.02.2024 i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e të paditurit /kundërshtarit të sigurimit TENZOR KOSOVO shpk me seli në Prishtinë PRISHET Aktvendimi KE.nr.2808/22 i datës 26.02.2024 i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, dhe Lënda i kthehet të njëjtës, në rigjykim dhe rivendosje

A r s y e t i m

Dhoma e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, KE.nr.2808/22 i datës 26.02.2024, në dispozitivin e aktvendimit ka vendosur: I. Aprovohet në tërësi si e bazuar propozimi i propozuesit të masës së sigurimit TENZOR I.S.S.L.L.C. me seli në Prishtinë, CAKTOHET masa e sigurisë ndaj kundërshtarit të sigurimit TENZOR KOSOVO shpk me seli në Prishtinë, Urdhërohet kundërshtarit të sigurimit TENZOR KOSOVO shpk me seli në Prishtinë, që menjëherë ti ndërpres veprimet që cenojnë markën tregtare të propozuesit të masës së sigurimit TENZOR I.S.S.L.L.C., të regjistruar sipas numrit 23948 dhe 23949, II Urdhërohet kundërshtari i sigurimit TENZOR KOSOVO shpk, që menjëherë ti largojë të gjitha shenjat të cilat cenojnë markën tregtar të propozuesit të masës së sigurimit Tenzor ISSLLC, III Masa e sigurimit mbetet në fuqi derisa mos të jepet vendim tjetër mbi masën e sigurimit

Kundër këtij aktvendimi ka paraqitur ankesë dhe plotësim ankesë, përfaqësuesi i autorizuar i kundërshtarit të masës së sigurimit, i cili e kundërshton aktvendimin e atakuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që ankesa të aprovohet si e themeltë, ashtu që ta ndryshoj aktvendimin KE.nr.2808/22 i datës 26.02.2024 i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, ashtu që propozimi për caktimin e masës së sigurimit të refuzohet si i pabazuar ose që i njëjti të prishet dhe lënda ti kthehet Dhomës së shkallës së parë.

Në përgjigjen në ankesë i autorizuari i propozuesit të masës së sigurimit deklaroi se pretendimet e propozuesit janë të pabazuara dhe i propozon gjykatës që të refuzohet ankesa në tërsi si e pabazuar dhe të vërtetohet aktvendimi KE.nr.2808/22 i datës 26.02.2024 i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në bazë të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi/ propozuesit të masës së sigurimit TENZOR I.S.S.L.L.C. me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të autorizuar me datën 19.12.2022 ka parashtruar në gjykatë padi, kundër të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit TENZOR KOSOVO shpk me seli në Prishtinë, për ndërprerjen e përdorimit të markës tregtare, me propozimin caktimin e masës së përkohshme të sigurimit kundër kundërshtarit të sigurimit ashtu që ti ndalohet kundërshtarit të sigurimit përdorimi i markës tregtare paditësit deri në vendosjen meritore nga ana e gjykatës lidhur me padinë.

Dhoma e shkallës së parë, ka mbajtur seancën dëgjimore me datën 26.02.2024 në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe ka nxjerr aktvendimin e atakuar me të cilin ka aprovuar në tërsi propozimin e propozuesit të masës së sigurimit TENZOR I.S.S.L.L.C. me seli në Prishtinë, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit. Në arsyetim të aktvendimit Dhoma e shkallës së parë referohet në dispozitat e nenit 9 par.2 nënp.2.2, 79 të Ligjit 08/L-075 për Markat Tregtare dhe nenin 297 të LPK-së. Gjykata vlerëson se kundërshtari i sigurimit nuk ka të drejtë që të përdor shenjat që cenojnë markën tregtare të propozuesit, në rastin konkret kemi të bëjmë me markë tregtare të regjistruar e cila ia njih pronarit ekskluzivitetin e përdorimit ndërsa nga provat e lëndës rezulton si i bazuar pretendimi i propozuesit për mundësin e shkaktimit të konfuzionit, për shkak se shkelje e markës tregtare konsiderohet edhe imitimi i saj, transkriptimi, transliterimi si dhe kur shenjës i shtohen fjalët shkronjat dhe të ngjashme. Mundësia e shkaktimit të konfuzionit është shumë e madhe për shkak se të dy produktet të paditësit dhe paditurit, janë të njëjtës natyrë, me qëllim të njëjtë përdorimi si dhe janë në konkurrencë me njëra tjetrën.. Prandaj janë plotësuar

kushtet ligjore nga neni 79 i LMT-së dhe 297 të LPK-së, sepse nga provat rezulton se i padituri/kundërshtari i sigurimit përdor shenjat të cilat janë pothuajse identike në aspektin konceptuar dhe vizual me shenjat e paditësit dhe padyshim që mund të shkaktojnë konfuzion tek konsumatorët. Në rastin konkret propozuesi e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës se ekziston rreziku se në rast të mos caktimit të masës së sigurimit, kundërshtari i sigurimit mund të vazhdoj me ndërmarrjen e veprimeve të cilat cenojnë të drejtat e propozuesit.

Në këtë gjendje të çështjes juridike, Dhoma e Shkallës së Dytë, ka gjetur se aktvendimi i atakuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika (n), e që përbejnë arsye për prishjen e këtij aktvendimi. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në atë se dispozitivi i aktvendimit është i paqartë, kontradiktor me vetveten, abstrakt, i mangët, dhe në kundërshtim me arsyetimin e tij, nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare dhe ato që janë dhënë janë kontradiktore.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së dytë, vlerësoi se në aktvendimin e atakuar, nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme, se arsyetimi i aktvendimit është i mangët në drejtim të vërtetimit të gjitha fakteve vendimtare që kanë ndikim në vendosjen e kësaj çështje kontestimore. Dhoma e shkallës së parë aktvendimin e atakuar e ka marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, duke mos vlerësuar edhe pretendimet dhe provat e tjera të lëndës, të cilat kanë të bëjnë me përdorimin e produktit të markës tregtare të regjistruar (aplikuar) nga të dyja palët ndërgjyqëse. Sipas Nenit 8.2 të LPK-së, gjykata ka për obligim që me ndërgjegje dhe me kujdes ta çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku për të ardhur te e vërteta materiale.

Dhoma e shkallës së parë, në arsyetimin e aktvendimit nuk sqaron në baza ligjore, cilat janë veprimet e kundërshtarit të sigurimit në drejtim të shkeljes së markës tregtare të paditësit/propozuesit të masës së sigurimit, ashtu që të vërtetohet se ekziston rreziku se në rast të mos caktimit të masës së sigurimit, kundërshtari i sigurimit mund të vazhdoj me ndërmarrjen e veprimeve të cilat cenojnë të drejtat e propozuesit. Përkundrejt vlerësimit të Dhomës së shkallës së parë, se kundërshtari i sigurimit përdor shenjat që janë identike në aspekti konceptuar dhe vizual me shenjat e propozuesit, Kolegji nga shkresat e lëndës, nuk gjen prova se kundërshtari i sigurimit ka ndërmarr ndonjë veprim konkret në përdorimin e produktit që është i mbrojtur me ligj, nuk është e qartë se cilat produkte të mbrojtura të propozuesit, janë përdor nga kundërshtari i sigurimit.

Kolegji vlerësoi, se në arsyetim të aktvendimit të atakuar, nuk janë shqyrtuar fare pretendimet dhe provat e ofruara nga kundërshtari i masës së sigurimit, se i njëjti ka të regjistruar (aplikuar) markën tregtare para aplikimit të propozuesit për regjistrimin e markës tregtare, për ti vërtetuar pretendimet se cili subjekt e ka të drejtën e shfrytëzimit të drejtës. Në shkresat e lëndës gjendet aktgjykimi KA.nr.140/22 i datës 30.01.2023 i kësaj gjykate, me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit Tensor ISS shpk, është anuluar vendimi i MTI nr.2072 dt.13.03.2019, dhe çështja i është kthyer të paditurit në rishqyrtim dhe rivendosje, mirëpo për shkak të mos vërtetimit në tërësi të gjendjes faktike, sa i përket aplikimit dhe regjistrimit të markës tregtare nga palët ndërgjyqëse tek

institucioni kompetent, Kolegji nuk ka mund të vërtetoi validitetin e regjistruar të markës tregtare kontestuese.

Duke u nisur nga kjo gjende e tillë e çështjes, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, ka gjetur se tani për tani, nuk mund të pranohet konkludim juridik i dhomës së shkallës së parë, si i drejtë dhe i ligjshëm sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate, për shkak të mos vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike gabimisht është zbatuar edhe e drejta materiale, prandaj është dashur që aktvendimi i goditur të priset dhe lënda ti kthehet Dhomës së shkallës së parë në rivendosje.

Në ri-procedurë, Dhoma e shkallës së parë duhet evituar shkeljet e theksuara më lartë, në atë mënyrë që të eviton kundërthëniet ekzistuese në mes dispozitivit me arsyetimin, arsyetimit me faktet vendimtare. Të sqarohen në baza ligjore, arsyet se si gjykata ka formësuar bindjen se në rastin konkret është bërë e besueshme ekzistimi i rrezikut se në rast të mos caktimit të masës ë sigurimit, kundërshtari i sigurimit mund të vazhdoj më ndërmarrjen e veprimeve të cilat çënojnë të drejtat e propozuesit.

Nga të cekurat u vendos sikurse në vendim në bazë të nenit 195.1 nën pikën c) të LPK.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.Dh.SHh.II.nr.947/24 datë 30.04.2024

Kryetari i Kolegjit  
Krenar Berisha